



Lajmet e Fundit:

Raporti ditor i ngjarjeve, Policia e Shtetit, 18 korrik 2022



18/07/2022

Tiranë – Parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i një konflikti me sende të forta, mes dy familjeve

Falë ndërhyrjes në kohë nga shërbimet e Policisë së Komisarariatit Nr. 2 në bashkëpunim me Forcën e Posaçme “Shqiponja”, parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i një konflikti me sende të forta, mes dy familjeve.

Vihen në pranga 2 nga shtetasit e përfshirë në konflikt.

Sekuestrohet një pistoletë zhurmuese që u gjet në vendin e ngjarjes.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 në bashkëpunim me Forcën e Posaçme “Shqiponja”, pas marrjes së njoftimit se në rrugën “Nuçi Naçi”, kishte konflikt, me sende të forta, mes dy familjeve, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasve:

– A. Sh., 37 vjeç dhe S. J., 22 vjeç, të dy banues në Tiranë.

Shtetasi S. J. dhe disa pjesëtarë të familjes së tij janë përfshirë në një konflikt për motive të dobëta, me shtetasin A. Sh. dhe disa pjesëtarë të familjes së tij.

Shtetasi A. Sh., gjatë konfliktit ka goditur me sende të forta shtetasit S. J., 20 vjeç dhe R. D., 16 vjeç, familjarë të shtetasit S. J., 22 vjeç, i cili më pas ka goditur me sende të forta shtetasin A. Sh.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një pistoletë zhurmuese që u gjet në vendin e ngjarjes, e cila dyshohet se i përkiste shtetasit të arrestuar S. J.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Gjirokastër – Goditën me mjet prerës dhe sende të forta 33-vjeçarin, arrestohet njëri prej autorëve të dyshuar, shpallet në kërkim bashkëpunëtori i tij

Kukës – Tentoi të vidhte në një banesë, arrestohet në flagrancë 22-vjeçari ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)